

Me Jakoven mbyllet edhe cikli i muzikantëve “atipikë” shkodranë që pat fillue me P. Kurtin e F. Ndojen, Át M. Gjokën e Dom M. Koliqin. Mbas Prenkës gjithshka do të ndryshonte. Kompozitorët, mbas tij, do të ishin për publikun, madje edhe për ekzekutuesit, pak ma shumë se emna abstraktë. Kompozitori do të shkruente tash e mbrapa vetëm muzikë të cilën do ta merrte në dorë një dirigjent për t’a luejtë me një orkestër me shumë instrumentistë e koristë; të gjithë këta të mësuar nga shumë mësues të tjerë të specialiteteve të ndryshme. Gati si një “prodhim-zinxhir”, sikur ndodhë në një fabrikë. Ndërsa Prenkës, si edhe paraardhësit e mësuesit të tij Át Martin Gjoka, iu desht të ishte i pranishëm në të gjitha proceset e atij “prodhimi-zinxhir”, si krijues, organizator, mësues e dirigjent.

Viti që vjen, 2017-ta, njëqindvjetori i lindjes së kompozitorit, do të jetë me siguri një rast me analizue edhe ma thellë veprën e tij. Në këto shenjime, ndonjiherë edhe përmes kujtimeve personale, do të përpiqemi të vemë në dukje, ma shumë se veprën, Njeriun dhe Artistin që tek ai ishin aq të lidhun, sa u transmetuen natyrshëm edhe tek krijimtaria e tij. Populli njohu në krijimtarinë e Prenkës një “produkt” që kishte dalë nga shpirti i një njeriut i cili jetonte me gëzimet e hallet e tij, që kishte shijen e kërkesat, sjelljen e zakonet në sintoni me të.

* * *

Si u formue Prenka si njeri dhe artist. Si u formue ai shpirt i ndjeshëm, por edhe burrënor, që zgjodhi muzikën si gjuhë për t’u shprehë?

Asht reduktive të thuesh se krijimtaria tij asht “produkt i rrethanave”, si shpesh përdoret kjo formulë. Në fakt ishte ai që u imponoi rrethanave kundërshtare drejtimin e jetës dhe krijimtarisë me talentin e vullnetin e tij të hekurt.

Bir i familjes së një artizani të thjeshtë, i treti ndër katër djem, të gjithë të pajisun me dhunti të veçanta, Prenka u dallue shpejt për talentin e rrallë muzikor. Kompozitori Át Martin Gjoka, mësuesi i tij i muzikës në Shkollën e françeskanve që i kishte dhanë klarineten djaloshit 12 vjeçar, pa shpejt përparimin e tij dhe interesimin që kishte për muzikën në përgjithësi. Ishte vetëm 17 vjeç Prenka kur Át Martini filloi t’i besojë atij drejtimin e bandës muzikore. Ishte një formacion që sot mund t’a quejmë të papërsëritshëm, historik, sepse aty banin pjesë, ndër të tjerë, edhe Çesk e Tonin Zadeja, Tish e Tonin Daija, Tonin Harapi, Simon Gjoni, Zef Gruda, Tonin Rrota etj., muzikantë që banë kaq shumë emën ma vonë.

Filloi si mësues fshati në Berdicë, Orosh e në Shkollën fillore të

franceskanëve. Ma në fund, në vitin 1942, arriti të realizojë andrren e tij, fillimin e studimeve në Konservatorin e njohun të Santa Çeçiljes në Romë. Por vetëm një vit. Lufta!

Jeta shpejt e vuni në sprovë. Përfundimi i konfliktit botnor, me atë që ngjau fill mbas, zhgënjeu pjesën dërmuese të vendit, posaçërisht Shkodren. Familja e Prenkës u ndodh në një situatë dramatike. Ndoci, vëllau që ishte shque në krye të demonstratave kundër pushtimit fashist, zgjodhi rrugën e luftës ndër male kundër pushtetit që u vendos. Kjo mjaftoi që Deda, ma i madhi dhe Çesku, ma i vogli vëlla, të arrestohen e të dënohen me tre vite heqje lirie. Vetë Prenka, baba Kolë e nana Rozë u internuen e u mbajtën në izolim. Kjo gjendje mund të topiste, madje edhe të ngrinte çdo vullnet, por jo atë të Prenkës.

Fillimi i punës si muzikant profesionist, mbas asaj që i ndodhi atij dhe familjes, do të duket një "aksident", një zgjidhje *a la* "deus ex macchina". Por edhe nëse e quejmë kështu, ky "aksident" u provokue nga zotësia e tij. U lirua nga izolimi vetëm pse dikujt iu kujtue që përvjetori i mbarimit të luftës po e gjente Shkodren "reaksionare" pa asnjë aktivitet artistik. Prenka u thirr për nevojë të madhe. Kjo ndodhi në shtator 1945. Me 28 nandor duhej festue përvjetori i parë! Mbas boshllekut që krijoi vdekja e Át Martin, Prenka ishte i vetmi që mund ta përmbushte këtë detyrë e në atë afat. Në ma pak se tre muej do të kompozonte tragjedinë e Fishtës, "*Juda Makabe*"! Jo vetëm kaq. Duhet ta orkestronte e duhet t'ja mësonte solistëve, korit dhe orkestres. "*Pa Prenken nuk mund të bahej vepra*", ishte "*aut-auti*" që iu vu autoriteteve dhe Prenka u lirue". (Z. Zorba: "*Disidenca e parë e organizuar e intelektualve të Shkodres-Juda Makabe 1945*").

Dishmitarët e kohës, Pjetër Gjoka e regjizori Zef Zorba, na kanë lanë përshkrime të hollësishme që tregojnë për punën e jashtëzakonshme të Prenkës i cili kompozonte, orkestronte e mësonte orkestren, por edhe korin e solistët. Fatmirësisht ai ishte, dhe vazhdoi të ishte gjatë gjithë jetës, shumë i fuqishëm fizikisht. Kapidan i vërtetë! Autoritar, kur merrte baketën në dorë, merrte me vehte e sugjestiononte artistët e publikun.

Në shkrimin e Zorbës tregohet edhe pse Prenka, vetë ai, Zorba, Gjon Hila, Pjetër Gjoka nuk zgjodhën një vepër kushtue luftës me vargje të Shefqet Musarajt, të Kolë Jakovës, apo të një tjetri. Ata zgjodhën Fishten me mesazhin e lirisë së popujve të shtypun që kërkojnë liri:

O ju popuj e fise t'njerzimit, / Lavde Zotit këndon i zani.....

N'zi hesht shtëpia e tempulli./ Ku nuk sundon liria/ e shuhet gjaja e popullit,

ku e t'huejve urdhnnon lakmia, / rrogat në troje t'veta/ kurr njeri atje s'lumnon.

Mbas suksesit të madh që pati vepra e cila u dha edhe në Tiranë, u rishfaq edhe vetëm për partizanët në Shkodër që vinin nga të katër anët

e vendit, sidomos nga jugu. Përsëri suksemi ishte sa i madh, aq i papritun. Mesazhi i lirisë, i shprehun me atë muzikë të frymzueme, prekte çdo zemër. Në artikullin e Zorbës përmenden edhe intelektualët e shquem të qytetit që dhanë ndihmesën e tyre në realizimin me sukses të kësaj veprë, ndër ta, rolin e madh të pater Gjon Shllakut. Dhe shton: *“Pjesa ma e madhe e tyre ma vonë u mbytën ndër burgje, u ekzekutuen e u përndoqën politikisht”*.

Ngjarjet rrodhën me shpejtësi për të keq e Shkodra, pra edhe Prenka, pau e provoi egërsinë e pashoqe të rregjimit të ri. Sa peshoi tek ai ajo periudhë që u skuq nga gjaku i mësuesve të tij françeskanë, i vëllait e i shokëve të tij, vetëm ai e dinte! Ai zgjodhi muzikën për të komunikue, për të punue, për të jetue dhe, pse jo, edhe për të harrue.

Falë talentit të tij të padiskutueshem, dukej se krijimtaria e Jakovës rridhte shpesh jashtë kontekstit politik që përpak po e eliminonte edhe atë si krijues. Dukej se ai kontekst që Prenka trimnisht u përpoq t’a shperfillë, tue zgjedhë lidhjen e thellë me shpirtin e popullit, e bani atë të jetonte në një sferë që ishte mbi atë realitet, që e anashkalonte atë.

“Dasma shkodrane” (1947), vepër e regjisorit, dramaturgut e studiuesit A. Skanjeti, (inskenim i këtij rituali kaq të vjetër e të pasun, të dokumentuem fatmirësisht sidomos nga Gjon Kujxhia), e bani për vete Prenkën. Edhe pse në atë kohë formacioni orkestral ishte modest, ishin solistë e sidomos kori që e banë të pandjeshme këte. Harmonizimi që u bani Jakova këngëve që kompozoi dhe këngëve populllore shkodrane ishte i përkryem. Zani i njeriut, “instrumenti” ma i bukur që ekziston, kur harmonizohet mjeshtrisht në korale, të shtangë me bukurinë e vet. Korale të Jakovës, falë edhe kësaj përvojë fatlume, do të tingëllonin tash e mbrapa si klasike të vërteta. Kjo e vërtetë u njoh nga të gjithë. Vepra pati jehonë shumë pozitive!

* * *

Kishin kalue tre vite që ishte vendosë rregjimi komunist e Prenka nuk i kishte kushtue atij as dhe një batutë të vetme nga krijimtaria e vet.

Ndodhi ajo që vertetë nuk pritej. Prenka u arrestue përsëri.

Se çfarë i ndodhi e se çfarë pësoi ai, duhet t’ua ketë tregue ndoshta vetëm të vetve. Por di me siguri – e në nderim të atij që e ka tregue, por që ka vdekë, nuk ia them emnin – se një xhelat i sigurimit, kur pat pa në pjacë Prenkën tue shetitë, shumë vite ma vonë, (Jakova kishte pak ditë që ishte shpallë “Artist i Merituem”), tha: “Si ndryshojnë punët! Unë këtij i kam ra shqelm me këpucë gjermane”.

Ashtu si arrestue, ashtu edhe u lirue.

Me siguri ndonji “i madh” mendoi se nuk mund të bahej pa Prenkën. Mbas hatasë që pësoi qyteti e mbas “thithjes” që u bani Tirana pjesës tjetër të muzikantëve të mbetun, Shkodra mbeti me të vertetë keq. Hapej Liceu Artistik në Tiranë në vitin 1946, ndërsa për Shkodrën, qytetin e muzikës për antonomazi, asnjë shenj. Ndërsa edhe në Kosovë, në vitin 1948, hapej

shkolla e muzikës në Prizren, për Shkodrën as përmendej një gjë e tillë.

Shkodra, që ishte mësue të kishte një jetë muzikore të gjallë, që kishte pasë disa orkestra frymore e disa formacione orkestrale e ansamble korale, ajo që kishte ushqye gjithë vendin me muzikantë, duhet të fillonte përsëri nga e para, duhet të mendonte për vete. Shkodra ishte si Feniksi...Po thuej edhe një herë nga e para!

Nën shembullin e mësuesit të tij, At. Gjokës, P. Jakova i vuni gjoksin punës, pa pritë që të vinte kuadri i shkolluem nga jashtë ose nga Tirana. Ai ishte mësuesi, dirigjenti e kompozitori e mbi të gjitha shpirti i gjithë veprimtarive muzikore. Kjo “veçanti” veç ia shton vlerën e veprës që na la Jakova, veç ia shton madhështinë e figurës dhe jetës heroike të tij. Por kjo “veçanti” ka ba edhe që krijimet e tij, gjatë procesit të mësimit dhe përgatitjes, të jenë objekt i verifikimit edhe për atë vetë. Amatorët, ekzekutuesit, baheshin ndigjuesit e parë e, vetë Prenka, kompozitori, bashkë me ta ndigjonte realisht tingëllimin në orkestracion, hamonizimin në koralet, veprën në përgjithësi. Kështu edhe Prenka rritej sëbashku me amatorët e fama e tij shpejt i kaloi kufijtë e Shkodrës.

Puna e Prenkës dhe e muzikantëve të tjerë krijuen bazat për të kalue në krijimin e ekzekutimit e veprave ma të mëdha. Prenka, mos të harrojmë, ishte autodidakt, por talenti i tij i madh ia fshihte këte mungesë. Si të gjithë jetën, si njeri e si artist, edhe tashti që kishte fitue nam, nuk desh “të shitet”, për atë që nuk ishte. Ai zgjodhi melodinë, si mjetin ma shprehës në krijimtarinë e vet e muzikën vokale kryesisht, e jo atë instrumentale, për të shprehë ndjenjat e veta.

Pse kryesisht muzikën vokale?

Pse atë populli do ta kuptonte ma mirë, por edhe pse në atë fushë ai e ndjente vehten ma të aftë. Pse jo atë instrumentale, simfonike? (Edhe pse nuk mungojnë vepra të realizueme mjeshtirisht nga ai, sidomos për orkestrën frymore). Nga pamundësia e tij për të dhanë maksimumin e shprehjes artistike?

Ndoshta, por edhe pse niveli i shijes së masës së njerëzve nuk do ta kuptonte. Ishte i sinqertë në krijimtari, ashtu si në jetë.

Vendi i tij i punës dhe kërkesat që vinin “nga lart” banë që edhe veprat e tij nuk mund të ishin ma të shkëputuna nga kontekstit politik e jashtë zhvillimeve që rregjimi donte t’i propagandonte e t’i glorifikonte edhe përmes artistit.

Por me veprën e Prenkës ndodhi mrekullia. Fatmirsisht karakteri abstrakt i figurës muzikore, në krahasim me artet e tjera, asht shumë ma specifik. Abstragimi shkon deri tek e mistershmbja, që e ban atë “produkt” të pelqehet ose jo, po në mënyrë subjektive, pra, pa parametra të përcaktuem objektivë. Mund të themi se krijohet një lidhje që kalon nga shpirti i krijuesit tek shpirti i ndigjuesit, tue anashkalue disi edhe analizën objektive. Kështu

ndodhi edhe me muzikën e Prenkës. Tue perifrazue një thanie të Leopardit, ndodhi ajo që shpirti iu hap irracionales, infinitit. Çuditrisht “Mrika”(1958), si atëherë edhe sot, nuk na kujton atë realitet, por na transmeton ndjenja njerëzore, që gjenialiteti e talenti i madh i Prenkës, që “foli” në atë vepër me një gjuhë thellësisht të frymëzueme e shqiptare, na trasmeton edhe sot ndjenja njerzore universale për çdo kohe: dashuninë e pastër, dashuninë e nanës, idhnimin, gëzimin. Mrika, Dava, Doda, Daja Gjini, janë personazhe të besueshme, e muzikalisht të tipizuem mjeshtrosh. Suksesi që vazhdon të ketë kjo vepër edhe kur jepet në formë koncertale, asht dëshmi e dashunisë që ka ndigjuesi shqiptar për atë vepër të frymëzueme.

Opera “Mrika” mbetet kryevepra e Jakovës. Asht dhe opera ma e bukur shqiptare e krijueme deri më sot, një gur i çmueshëm në gjerdanin e muzikës shqiptare, por edhe një dhuratë e madhe që autori i bani qytetit e amatorëve të vet. Teatri i Operas dhe Baletit do ta kishte pasë për nder ta shfaqte i pari këtë opera. Prenkës, kjo gjë, as i kishte shkue ndonjiherë në mendje. Nuk la gur pa luejtë e solli në qytet, nga ana e anës të gjithë muzikantët shkodranë që i nevojiteshin. Sa rekrutë u ulen nga makinat që po niseshin në repartet ushtarake ku ishin caktue! Për çdo njerin prej nesh që patëm nderin të ishim pjesmarrës në atë debutim historik, ai kishte mendue, ndjekë e derdhë djersë me vite. Për autorin e këtyre radhëve, Jakova ishte ai që i dha drejtimin e jetës. Pa mbushë katërmëdhjetë vjeç, më mori në orkestren simfonike dhe në moshën 17 vjeç më transferoi në qytetin e Shkodres, vetëm dy muej mbasi më kishin emnue mësues në Mirditë. E jam vetëm njeni prej shumë e shumë të tjerëve që Prenka i rriti si muzikantë dhe u kujdes në shumë raste edhe për sistemimin e tyre në punë. Të gjithë ai ansambël i madh që natën e 1 dhjetorit 1958 do të hynte bashkë me Jakovën në historinë e muzikës shqiptare, pati kujdesin, udhëheqjen e dashuninë e tij.

Veçanërisht atë natë, të gjithë ne kërkonim shikimin e tij që na ngjallte siguri. Si gjithmonë, por atë natë edhe ma shumë, ai ishte për ne: kapidani, muzikanti, dirigjenti, organizatori, sportivi, shtatnalti, serjozi, i dhembshuni, bujari e trimi, që na bënte të gjithë ne, nxënësit e tij, të ndjeheshim të vlefshëm, të randësishëm, të aftë nën baketen e tij.

Kjo nuk ndodhi me 28 apo me 29 nandor, si ndodhte zakonisht me vepra e inaugurime, por me 1 dhjetor, vetëm pse Prenka insistoi (e ia arriti, pse ia njihnin dellin e tij kur ngulte kambë) që shfaqja të shtyhej, sepse me 27 nandor vdiq aktori i madh Zef Jubani, e ai desh ta nderonte deri në fund kujtimin e tij. Kjo veç e rriti edhe ma shumë respektin e njerëzve për Jakovën, ia shtoi edhe ma shumë magjinë e asaj nate.

Pas shfaqjes me sukses të operas “Mrika” në Shkodër, trupa u ftue për shfaqje edhe në Tiranë, ku asistoi vetë E. Hoxha që të nesërmen i priti autorët sëbashku me disa përfaqësues të trupës artistike. Shtypi e vlerësoi

veprën, pjesët e së cilës hynë e vazhdojnë të jenë në repertorin artistik në shumë koncerte.

Tashmë dukej se Prenka ishte rehabilitue plotësisht. Por shihej edhe qartë se kjo gjatë e ngrohje e as e ftohte atë.

Ai vazhdonte të punonte. Nuk thonte “Provat janë në orën...”, por “Mësimi i orkestrës asht në orën...”. Kishte edhe një merak: ta ndigjonte orkestrën në rolin e vetë ma shprehës, pra jo vetëm si shoqruar. Me shijen e kërkesat artistike që kishte, me njohjen e thellë të aftësive teknike e shprehëse që kishte orkestra të cilën ai e kishte krijuar, zgjodhi një repertor të denjë klasik instrumental, ku përfshihej overture e operas “Grabitja nga Haremi” e Mozartit, pjesë të njohura nga Karajev, Delib, Dvorzhak, Bellini etj. “Koncerti Simfonik” (1960), kështu e quajti ai këto herë, u ekzekutue me nivel artistik dhe emërtimi “orkestra simfonike” mori edhe ma kuptim, tue i dhanë edhe statusin “gjysë profesioniste”, që në atë kohë do të thonte edhe një mijë lekë në muej, (që për puntorin me 4, shumë 5 mijë lekë në muej, ishte një ndihmë e madhe).

Por Prenka nuk ishte “makinë”. Ishte i veçantë, por edhe i zakoshëm. Gjithnjë i singjertë. “Kur marr pjesë në një konkurs, unë due me fitue”, thonte haptë. Mori pjesë vetëm një herë në festivalin e radios në vitin 1961 me këngën “Margjelo” e mori çmimin e dytë. Por atë vit nuk u dha çmim i parë (!). Kujtoj edhe ndonjë rast që veç ma shton adhurimin për Prenkën, më ban edhe me buzëqeshje (e jo me m’u lidhë lamshi në fyt sa herë e kujtoj me atë fund që pati...). Kur nuk zhvilloheshin provat (dhe nuk e priste Klotilde Shantoja, sopranoja me za brilant, dashunia e tij e vetme, e madhe e me tallaze...), pra para se t’a banim bashkë rrugën për në shtëpi, nga Serreqi, më thonte: “Ta bajmë nga një lojë”. E nisim me pingpong. Mëqë fitoja, më thonte të luenim biliardo, ku më linte me stekë në dorë... Me dy shokë të mi moshatarë “bani garë” në Shirokë tue ndejë në zhyt gadi dy herë ma shumë se ne. Prenka! që i bleu kostum një shokut tonë që vërtetë kishte mbetë keq në kulmin e rinisë. (“Ma kanë dhurue këto kostum, por për mue asht shumë i vogël”); që ndihmoi dy koriste të vorfna edhe me ushqime; që Sosen, puntoren e shërbimit e trajtonte si nanën e vet; që nderonte në ceremonitë mortore të gjithë të afermit e ansamblit të tij, e jo vetëm; që disiplinën e kërkonte jo vetëm ndaj atyne që kishte “nën baketë”, por edhe ndaj atyne që vinin “të miratonin” programet e që në një rast, ndërsa flisnin mes tyne, panë partiturat e hedhuna në hava e ndigjuen Prenken të thonte: “Bajmë pak pushim!”. Prenka! (Edhe sot habitem që, me gjithë atë adhurim që kishim për te, e thërrisim me emën).

* * *

Kur marrim guxim të shkruajmë për Jakovën tue hy në maje të gishtave në panteonin e jetës e vepres së tij, pa dashtë na shkon mendja edhe tek vdekja e tij tragjike. E kjo na ban të jemi edhe ma të kujdesshem kur

shkruejmë për te.

Prenka vërtetë ishte si ajo makina me motor të fuqishëm, por ishte edhe shumë i ndjeshëm. Emni që kishte fitue, veç e bani ma punëtor. Afrimi i 500 vjetorit të lindjes së heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti, datë e shenjueme edhe për organizmat ndërkombëtare, bani edhe parinë e vendit të impenjohej. Me çka tjetër veçse me një opera mund të bante figurë të mirë rregjimi ndaj shumë delegacioneve të hueja që priteshin për këtë përvjetor? Asht fakt që opera kushtue heroit tonë kombëtar, Prenkës iu porosit “nga lart”. (E pra, tashma vendi kishte shumë kompozitorë të tjerë që kishin ba emën dhe kishin përfundue studimet në konservatore të hueja).

Mbas shumë diskutimesh mes Siliqit dhe Jakovës me një grup të ngushtë, u vendos libreti mbi të cilin do të muzikohej vepra. Në një kohë kur “partishmëria” kishte fillue të hynte deri tek krijimet ma të thjeshta, një vepër e tillë, me temen që trajtonte, ishte një çlirim, ishte një burim frymëzimi i pashtershëm. Kjo gja e gëzonte Prenkën dhe punën e filloi me dëshirë.

Por ndërsa Jakova, i tretun, punonte me frymëzim e me vullnetin që e karakterizonte, në jetën politike të vendit vëreheshin ndryshime të vullshme, e gjithnji për të keq. Komunistët shqiptarë, majmunët e përjetshëm, nën shembullin e Kinës po përgatisnin revolucionin “tonë” kultural që mbylli kishat e ashpërsoi në kulm luftën e klasave. “Vija e masave” nuk ishte gja tjetër veçse një mënyrë për fuqizimin e kultit të Enver Hoxhës, të cilin Skenderbeu do ta linte në hije.

Ndodhi ajo që nuk kishte ngja asnjherë. Edhe pse Prenka kishte përfundue kompozimin e operas “për canto e pianoforte”, filluen diskutimet e “dirigjueme” nga nalt për miratimin e saj. Vepra, që kishte tashma ndërtimin e vet, zhvillimin gradual e logjik edhe në dramaturgjinë muzikore, pësoi ndryshime nga ma të ndryshmet: skena dhe tablo u spostuen ose u hoqën, tue cënue kështu edhe dramaturgjinë e veprës. “*U ngushtuan së tepermi roli e veprimet e personazheve kryesorë, madje, ndonjë nga ato u hoq si nga libreti ashtu edhe nga partitura muzikore*”. (S. Kalemi-“Prenkë Jakova”, 2006)

Këto ndryshime, por mbi të gjitha ky qëndrim, e preken shumë Prenkën. Pati dhe një paralizë të lehtë. Harapi, Krantja, Daija e Zadeja e ndihmuen Jakovën në plotësimin e disa orkestracioneve që, për shkak të diskutimeve pa fund, kishin mbetë të papërfundueme nga vetë autori. Por delli krijues i Jakovës, bukuria e muzikës së tij kaq të frymëzueme, ndjeheshin qartë në vepër. Dëshmi për këtë asht edhe prova e përgjithëshme.

Një pjesë e muzikantëve nga Shkodra dhe vendi, tue mos pasë mundësi të ishin të pranishëm në premierë, preferuen me asistue në provën e përgjithëshme. Një triumf i vërtetë! Ma shumë se 15 minuta duertrokitje.

Prenka ishte i gëzuem, por përmbahej.

Erdh dhe premjera e 17 janarit 1968. Ishte një publik “i zgjedhur”, por jo nga ana artistike: nomenklatura, studiues, përfaqes të organizatave të masave etj. Njerzit në sallë ma shumë shikonin me bisht të synit nga llozha qendrore, për të pa reagimin e “të madhit”, se sa ndiqnin operën që në fakt ishte një ngjarje artistike e jashtëzakonshme. Shqiptarët shkruenin një vepër madhore për heroin e tyne, Skenderbeun, ma të madhin e të gjitha kohëve. Europa i kishte kushtue heroit tonë dymijë vepra, ndër ta dhe opera që kishte shkruie Vivaldi. Volteri kishte thanë për heroin tonë se sikur perandorët e Bizantit të kishin qenë Skenderbegë, nuk do të kishte ra Konstantinopoli. Po ç’mendonte ai në llozhën qendrore, ai që kishte sfidue Bashkimin Sovjetik dhe tashti kishte sfidue edhe vetë Zotin me revolucionion kulturor “alla kinezçe”? Nji ditë ma parë, në mbledhjen jubilarë per Gjergj Kastriotin, Mehmet Shehu, këte herë edhe në rolin e historianit, e quejti Skendebeun pak ma shumë se një feudal...

U duk qartë se me shfaqjen e operas kushtue Skenderbeut regjimi kishte krye vetëm një detyrë protokollare, një ceremoni që duhej të bahej, ndërsa “Zëri i Popullit” në artikullin me titullin e thatë “Opera Skenderbeu”, që nënshkruhej nga dy firma të njohuna, por me siguri të porosituna, thonte se autori “*duhet të ulet përsëri në partiturat e operas e të punojë mbi to me këmbëngulje e serjozitet*”. (Vihej në dyshim kambëngulja e serioziteti i Prenkës! Ky ishte kulmi!). Opera, që natën e premierës nuk u prit me entuziazëm – përdorim një eufemizëm këtu – u hoq nga repertori i Teatrit të Operas.

Por cila asht vlera e vërtetë e operas, vlera e asaj që shkroi Prenka, pra e asaj të “pasakatueme”? Ndoshta nuk do ta dijmë asnjherë e aq ma shumë tashti që bajmë kujdes “ta fshehim” heroin nga ndonji mik “strategjik” që vjen nga Lindja. Mos duhet ta presin këte nga shqiptarët e Amerikës e arbëreshet për të pa e vlerësue madhështinë e bukurinë e veprës e me gjykue se si e sa ka evolue gjuha muzikore e Prenkës? Por edhe pa këte vlerësim, Jakova mbetet kompozitori ma i shquem shqiptar i muzikës vokale-operistike në gjysën e dytë të shek. XX.

Por Prenka edhe pse “i vramë” ishte i veçantë, i papërkulun. Mori përsëri në dorë ansamblin me të cilin kishte lidhë jetën dhe, në takimin kombëtar të Vlorës të Prillit 1969, dha një shfaqje të përkryeme. Juria e vlerësoi me çmimin e parë ansamblin e Shkodres. Flamurin e mori ansambli i qytetit “Stalin”. (Në shfaqjen e atij ansambli kishte asistue kryeministri).

Por diçka ndjehej në ajr. Thuhej se në listat e dekorimeve të amatorëve të Shtëpisë së Kulturës me rastin e 25 vjetorit të Çlirimit mungonte emni i Prenkës. E dinte Prenka këte? Jeta vazhdonte e bashkë me atë edhe veprimtaritë e rradhës, por gjithshka kishte ndryshue, për të keq; ndjehej një atmosferë e ftohtë që ndillte vetëm keq.

Me kthimin e Katedrales në pallat sporti, “të mëdhejt” e Shkodrës preferonin ma shumë atë ambjent për mitingje e koncerte sesa sheshin e qytetit. Ndërsa për Prenkën e ne, koncertet me atë tematikë në atë ambjent, na dukeshin si sakrilegj i vertetë. Jam dëshmitar i një koncerti që u zhvillue aty. Mbas fjalimit kryesor e përshendetjeve filloi koncerti. Isha në pultin e parë me Ndoc Shllakun, pra fare afër Prenkës. Në mes të koncertit, pashë e ndjeva se dikush iu afrue e i tha se sekretari i partisë për kulturën kërkonte shkurtimin e koncertit. Nuk di se si ta përshkruej shikimin e Prenkës në përgjigje të atyne fjalëve. “Emisari” çoi vetëm supet e kjo u duk se ishte përgjigja që i dha atij që e kishte nisë në atë mision të pamujtun. Partia mendonte se Prenka tashma nuk ishte ma “i pazevendsueshmi”. Vetë “Zëri i Popullit” kishte thanë...

* * *

Kompozimi i tij i fundit ishte Hymni i Republikës, (ishte shpallë një konkurs sepse propozohej të ndryshonte Hymni Kombëtar). Na e tregoi shumë vetëve. Strofa ishte si një *requiem*, si një lutje. E të mendosh se e kishte fillue krijimtarinë e tij me një “Ave Maria” në vitin 1942!

Me 16 shtator 1969 Prenkë Jakova u gjend i përgjakun në pjesën e mbrapme të Shtëpisë së Kulturës, poshtë dhomës së tij të punës që gjendej në katin e dytë.

“Na vdiq Prenka”, kështu u hap lajmi i kobshëm në Shkodër gojë në gojë.

Asnjë ceremoni zyrtare! Të gjitha kunorat njiilloj. Shquhej vetëm njena, në formën e Lyres, bû me gjethe manjole në shtëpinë e pionerit nga tre orkestrantë, nxanës të tij.

Sa ma shumë që koha kalon, aq ma shumë rritet ndër ne figura e P. Jakovës si njeri dhe artist. E na vjen e natyrshme pyetja: si do të kishte qenë jeta në kohën e diktaturës pa këto njerëz të mëdhej, që na banë “të harrojmë” edhe pse për pak, hallet e mëdha rreth nesh, ferrin ku e kishte fundosë vendin tirania.

Abstract

Prominent composer Prenkë Jakova (1917-1969) remains to this day the most original and peculiar artist in Albanian opera and vocal music. His opera *Mrika* (1958), in fact, is his masterpiece and the most popular of his compositions.

Educated and brought up by the Franciscans in Shkodra, who worked with steadfast love for Albanian education, art and culture, Prenkë Jakova

was favoured by the stars in having as teacher Fr Martin Gjoka, the first professional Albanian composer.

Because of the Second World War, Jakova's studies at Santa Cecilia in Rome came to an abrupt end. His life afterwards was entirely marked by his passionate work as a half, self-taught genius.

Though composing in the Communist regime, which imprisoned him twice, Jakova through his tireless work created and educated a whole generation of future musicians – author Prennushi is one them – as well as a choir and the first philharmonic orchestra in Albania.

However, his widely performed compositions recalling folk music themes are his most remarkable achievements.